



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, datë 16/07/2020

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 88/2019 datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Aktit Normativ të datës 6 Korrik 2020, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 100, datë 5.2.2020, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2020", Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.3, datë 24.2.2020, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", të ndryshuar, si dhe Urdhërit të Ministrit nr. 278, datë 16.07.2020 "Për alokimin e fondit shtesë të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2020, sipas Aktit Normativ, jep lajmin e mirë për alokimin e fondeve, sipas masave mbështetëse, në vlerë 400 000 000 lekë. Ky fond, do t'i bashkangjitet fondit të mëparshëm, prej 743,900,000 lekësh, në mënyrë që të mbulojë një pjesë të madhe të aplikantëve që kualifikohen dhe që s'kanë mangësi në kriteret e përcaktuara më parë.

Në sajë të këtij Akti Normativ, AZHBR bën përditësimin e listës së aplikimeve të kualifikuara, së bashku me vijën e financimit.

Njoftimi mbi përditësimin e numrit rendor për **Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**, gjendet në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al, për secilën masë mbështetëse të financuar nga Programi Kombëtar, viti 2020. Gjithashtu AGROPIKAT janë në gadishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit. Afati i dorëzimit të dokumenteve shtesë për aplikantët që ndodhen mbi vijën e financimit është deri më datë **30.07.2020**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.

Kujdes, për aplikantët që ndodhen mbi vijën e financimit që në fazën e parë dhe kanë mungesë dokumentacioni, duhet t'i dorëzojnë ato deri nesër, datë **17.07.2020**. Dorëzimi i tyre përtej kësaj date sjell skualifikim të aplikantit fitues.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve që ndodhen mbi vijën e financimit:

Masa 1: Tufa bazë e matrikulluar – Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 2964

Masa 2: Bletaria - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 1344

Masa 3: Financime për zëvendësim plastmasi termik - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 386

Masa 4: Mbjellje bimësh mjekësore dhe aromatike - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 248

Masa 5: Mbështetje për fermat organike - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 125

Masa 6: Çertifikimi Global Gap - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 33

Masa 7: Investim në agroturizëm - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 3.